

MIRATOHET
MINISTRI
YLLI PANGO

STATUTI

I

FEDERATËS SHQIPTARE TË SHAHUT

Ne Tirane sot me daten 09.02.2008,nga ne klubet dhe shoqatat e shahut si me poshte :

K.S."Butrinti",K.S."Apollonia",K.S."Besa"K.S."Naftetari",K.S."Lushnja",K.S."Luftetari",K.S."Teuta",K.S."Erzeni",K.S."Flamurtari",K.S."Tirana",K.S."Partizani",K.S."Vllaznia",K.S."Veleciku",K.S."Dajti",K.S."Tomorri",shoqatat" Tepelena", Permeti,"Unioni i veriut"

U krijua shoqata jo fitimprurese sportive

Federata Shqiptare e Shahut

Themeluar ne vitin 1933 si Bashkimi i Shahisteve Shqiptar' qe eshte Shoqata Kombetare e sportit te Shahut ,Tirane,Shqiperi

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Forma Ligjore, Përbërja, Selia

1. **“Federata Shqiptare e Shahut”** (për efekt të këtij statuti më poshtë do t’i referohemi **FSHSH**) është person juridik privat që krijohet në formën e shoqatës, e cila përfaqëson bashkimin vullnetar të shoqatave, klubeve dhe shoqërive sportive të shahut, që vepron në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil, ligjit nr.9376, datë 21.04.2005 “Për Sportin”, ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, ligjit Nr.8789, datë 07.05.2001 “Për Rregjistrimin e Organizatave jofitimprurëse”, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.
2. FSHSH, si anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Shahut (FIDE) dhe të asaj Europiane (ECU), respekton statutin dhe rregulloret, direktivat dhe vendimet e tyre dhe siguron respektimin e tyre nga të gjithë anëtarët e saj.
3. FSHSH njeh autoritetin e Ministrisë Përgjegjëse për Sportin në kontrollin e respektimit të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të saj.
4. Selia e shoqatës do të jetë në adresën: Rruga “Dervish Hima”, Nr.31, Tiranë.

Neni 2

Emri, Sigla, Simbolet, Vula

1. Emri i plote i kësaj shoqate do te jete **“Federata Shqiptare e Shahut”**.
2. Sigla e saj do te jete **“FSHSH”**.
3. FSHSH ka stemen, flamurin dhe vulen e saj te cilat pershkruhen me poshte:
 - a. **Stema e FSHSH** eshte nje kuadrat me kater katrore bardhe e zi, me shqiponjen e zeze ne qender, mbi te cilen shkruhet me germ ate kuqe F.SH.SH 1933” dhe poshte saj “Federata Shqiptare e Shahut”.
 - b. Flamuri i FSHSH eshte stema e FSHSH e vendosur ne ¼ lart-majtas te formatit te flamurit zyrtar, ne sfond te kuq.



- c. Vula e FSHSH ka forme rrethore dhe permban siglen e shoqates ne qender (**nje fushe shahu ku ne qender ka nje kale**) dhe emrin e plote pergjate perimetrin dhe viti 1933.
2. Stema e FSHSH do te vendoset ne te gjithë dokumentat e perfaqesimit, karten e anetaresise, si dhe ne aktet e tjera te nxjerra prej saj.
3. Ndryshimi i ketyre simboleve behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme, kur jane dakord 3./4 e anetareve me te drejte vote te pranishem.

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

Neni 3

Qëllimi dhe Funkcionet

1.Federata Shqiptare e Shahut eshte organizate jofitimprurese.Te ardhurat qe krijohen ne F.SH.SH.nga burime te ndryshme(ligjore) riinvestohen 100% per zhvillimin e aktivitetit te F.SH.SH.

2.Federata Shqiptare e Shahut ka keto objektiva dhe detyra:

- a. Te zhvilloje,promovoje,kontrolloje, dhe te regulloje aktivitetin sportiv te shoqatave e klubeve ne Federate,ne te gjitha format,ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise,ne perputhje me kete statut.
- b. Te ndihmoje ne menyre te kualifikuar ne rritjen dhe zhvillimin e maredhenieve miqesore midis antareve te federates, te mbroje te drejtat e anetareve te saj,dhe te kujdeset per zgjidhjen e problemeve tekniko-organizative,sportive, duke u mbeshtetur ne statut,rregullore,legjislacionin Shqiptar,si dhe ne aktet ligjore Nderkombetare te veprimtarise se sportit te Shahut.
- c. Te drejtoje dhe te kujdeset per mbarevajtjen e te gjithe gjyqtareve te F.Sh.Sh.kombetare e nderkombetare te aderuar ne Federate.
- d. Te organizoje Kampionatin Kombetar dhe Kupa e Shqiperise,te shpalle “ekipin kampion kombetar” dhe ekipin fitues te “Kupes se Shqiperise”ne Sportin e Shahut.
- e. Te perfaqesoje Republiken e Shqiperise ne F.I.D.E.
- f. Te organizoje ekipin Kombetar dhe te marre pjese ne veprimtarite sportive nderkombetare,ose te autorizojte pjesemarjen e antareve te saj ne keto veprimtari.
- g. Te organizoje ne Republiken e Shqiperise veprimtari sportive Nderkombetare dhe te jape leje per organizimin e tyre nga anetaret e saje.

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

KREU II
ANËTARËSIA
NENI 4

1. Anëtarët e FSHSH duhet të jenë persona fizikë ose juridikë, si sportistë, trenerë, gjyqtarë, veteranë e dashamirës të shahut, klube, shoqata e shoqëri sportive, të cilat pranojnë aderimin pranë saj duke i respektuar statutin dhe rregulloret e funksionimit të F.Sh.Sh.
2. Anëtarët e rregjistruar në FSHSH janë të detyruar të kontribuojnë për FSHSH nëpërmjet pagimit të kuotizacioneve të përcaktuar nga A.P.
3. Selia e një anëtari të FSHSH është në territorin shqiptar.

Neni 5
E drejta e Fitimit të Anëtarësisë

1. Pas regjistrimit në gjykatën e Tiranës si person fizik apo juridik, shoqata kërkon të drejtën e anëtarësisë në FSHSH.
2. Komiteti Drejtues i jep shoqatës të drejtën e të qenit anëtar provizor i federatës deri në Asamblenë e rradhës.
3. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi anëtarësinë e një anëtari, por ajo nuk mund ta refuzojë atë përderisa organizimi i kërkuarit nuk është në kundërshtim me statutin e federatës.

NENI 6
Te drejtat e Anetareve

Anëtari i FSHSH ka të drejtë:

1. Të pajiset me kartën e anëtarësisë.
2. Të pajiset me statutin dhe rregulloret e FSHSH.
3. Të përfaqësohet me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme.
4. Të informohet me vendimet e marra nga organet drejtuese të federatës.
5. Të pajiset falas me botimet e ndryshme që bën federata.
6. Të marrë pjesë në aktivitetet zyrtare e miqësore, kombëtare dhe ndërkombëtare që organizon FSHSH., sipas kritereve të përcaktuara nga KD dhe Asambleja e Përgjithshme
7. Të njihet më parë me programin e mbledhjes së A.P dhe dekomencionin përkatës.

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

Neni 7
Detyrimet e Anëtarëve

Anëtari i FSHSH detyrohet:

1. Të jetë korrekt ndaj federatës, që nënkupton, që çdo anëtar të mos ndërmarrë veprime kundër interesave të FSHSH.
2. Të paguajë çdo detyrim ose tarifë të caktuar nga Asambleja për garantimin e qëndrueshmërisë së aktiviteteve në funksion të federatës.
3. T'i komunikojë FSHSH çdo ndryshim në statutet dhe rregulloret e anëtarit si dhe listën e personave ose zyrtarëve me të drejtë firme për të hyrë në marrëveshje ligjore me palët e treta.
4. Të pranojë dhe t'u nënshtrohet statuteve dhe rregulloreve të FSHSH, FIDE-s dhe ECU.
5. Për Asamblenë e vet të Përgjithshme të zgjedhë organet drejtuese, ekzekutive dhe nëse e gjykon të arsyeshme edhe organin e vet disiplinor.
6. Të njohë parimet e ndershmërisë, integritetit dhe sjelljes korrekte sportive.
7. Të njohë të gjitha detyrimet e tjera që dalin nga këto statute, rregullore, direktiva dhe vendime të FSHSH.

Neni 8
Pezullimi

1. Shkelja serioze e statuteve, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FSHSH i jep të drejtën Asamblesë së Përgjithshme të pezullojë çdo anëtar të saj nga anëtarësimi në FSHSH për një periudhë, e cila parashikohet nga AP.
2. Në raste urgjente KD mund të japë pezullim provizor deri në asamblenë e rradhës e cila do të shprehet me një vendim për vendimin e KD-së.
3. Çdo vendim pezullimi përbën humbjen e të drejtave që lidhen me statusin e anëtarit për sa kohë që pezullimi mbetet në fuqi.

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

Neni 9
Humbja e Statusit të Anëtarit

1. Statusi i anëtarit mbaron me dorëheqjen ose përjashtimin e anëtarit, ose kur humbet zotësinë juridike për të vepruar.
2. Përjashtimi bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në rastet, kur nuk është derdhur kuota e anëtarësimit, ose si pasojë e veprimeve të padenja, në kundërshtim me interesat e federatës siç parashikohet në rregulloret e federatës.
3. Humbja e statusit të anëtarit nuk e liron atë nga detyrimet e veta financiare të papërbushura kundrejt FSHSH ose anëtarëve të tjerë. Pezullimi e përjashton atë nga të gjitha të drejtat që lidhen me FSHSH, veçanërisht nga ato që lidhen me kapitalin e regjistruar në FSHSH.

Neni 10
Dorëheqja e Anëtarit

Një anëtar(klub sport.apo shoqate) mund të paraqesë me shkrim kërkesën e tij për dorëheqje me kusht që ajo të bëhet e vlefshme vetëm në fund të vitit financiar. Kërkesa duhet të paraqitet të paktën 30 ditë më parë. Sekretari i Përgjithshëm bën çregjistrimin.

KREU III
ORGANIZIMI
Neni 11
Organet Drejtuese

Organet drejtuese të FSHSH janë:

- 1.Asambleja e Përgjithshme.**
- 2.Presidenti.**
- 3.Komiteti Drejtues.**

Komisionet janë:

- 1. Komisioni i Disiplinës.**
- 2. Komisioni i Apelit.**
- 3. Komisioni Tekniko Arbitral.**
- 4. Komisioni i Financës.**

Neni 12
Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës e drejtues i FSHSH. Vetëm një Asamble e mbajtur në përputhje me rregullat e këtij statuti, ka autoritetin të marrë vendime.
2. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë anëtarët e saj të cilët përfaqësohen me 1 (një) votë.
3. **Në Asamblenë e përgjithshme marin pjese pa të drejtë vote, anëtarët e nderit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, anëtarë të Komitetit Drejtues dhe Sekretari i Përgjithshëm i FSHSH.**
4. KD vendos mbi pjesëmarrjen e personave të tjerë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
5. Këta persona nuk kanë të drejtë vote dhe mund të diskutojnë vetëm me leje të drejtuesit të Asamblesë.

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

Neni 13

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

****Asambleja e Përgjithshme e FSHSH ka këto kompetenca****

- a. Miraton ndryshime të statutit të FSHSH në përputhje me ligjin për sportin dhe ligjin për organizatat jofitimprurëse.
- b. Miraton llogaritë vjetore të Federatës.
- c. Miraton raportin e Komitetit Drejtues të FSHSH.
- d. Voton buxhetin e FSHSH.
- e. Miraton organin e kontrollit financiar të pavarur nga FSHSH sipas ligjeve në fuqi.
- f. Përcakton numrin e plotë të anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.
- g. Zgjedh Presidentin e federatës.
- h. Zgjedh anëtarët e Komitetit Drejtues.
- i. Miraton propozimet e anëtarëve për dhënie të titujve të nderit brenda juridiksionit të federatës.
- j. Miraton pranimin, pushimin, pezullimin apo dorëheqjen e një anëtari sipas parashikimit në këtë statut.
- k. Heq mandatin e një anëtari apo të organeve të federatës sipas parashikimit në këtë statut.
- l. Deklaron shkrirjen e federatës dhe likujdimin e veprimeve të saj financiare.
- m. Miraton Kalendarin e aktiviteteve të programuara nga K.D

Neni 14

Emërimi i Delegatëve

1. Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të FSHSH janë të detyruar të mbledhin Asamblenë e Përgjithshme të shoqatës, klubit, etj, për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të FSHSH.
2. Anëtarët (klubet, shoqatat, etj) dërgojnë pranë federatës personat zyrtarë të autorizuar për përfaqësimin e tyre.
3. Te mandatarit zyrtarë duhet të kenë dokumentin e identifikimit (pasaportë, certifikatë).
4. E drejta e votës nuk mund t'i delegohet një anëtari tjetër.
5. Anëtarët (klubet, shoqatat, apo shoqëritë) janë të detyruar që të sjellin emrat e personave të autorizuar për t'u përfaqësuar me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme, pranë sekretariatit të FSHSH, jo më vonë se 20 ditë përpara datës së zhvillimit të Asamblesë.

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

Neni 15

Numri dhe Percaktimi i te Mandatuarve

1. Numri i te mandatarve përcaktohet si më poshtë:
 - **Çdo klub sportiv ka 1 (një) mandat**
 - **Çdo shoqatë sportive ka 1 (një) mandat**
2. Cdo delegat ka te drejten e (1) nje vote.
3. Nuk mund te perfaqesohet me te drejte vote ne Asamblen e Pergjithshme
 - a. Sekretari apo drejtori ekzekutiv i nje klubi sportiv, shoqate sportive.
 - b. Persona qe kane qene perfaqesues me te drejte vote ne nje federate tjetër.

Neni 16

Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme

1. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme thirret nga Presidenti jo më pak se një herë në vit. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë duhet t'u dërgohet anëtarëve 30 ditë përpara ditës së zhvillimit të saj.
2. Rendi i ditës vendoset nga KD. Rendi i ditës, raportet e aktiviteteve, buxheti, llogaritë dhe çdo dokument tjetër duhet t'u dërgohen anëtarëve 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
3. Çdo anëtar ka të drejtë të propozojë përfshirjen në rendin e ditës të një çështje. Kjo kërkesë duhet të paraqitet në sekretariatit e FSHSH, 7 ditë përpara mbledhjes.

Neni 17

Rendi i Ditës për Asamblenë e Përgjithshme të Zakonshme

KD miraton Rendin e ditës të AP sa me poshte, por nuk kufizohet vetem :

- a. Verifikimi i mandateve
- b. Raporti i Presidentit.
- c. Miratimi i raportit të aktiviteteve të KD-së.
- d. Miratimi i raportit financiar.
- e. Miratimi i veprimtarive financiare për vitin pasardhës.
- f. Zgjedhjet për çdo vend vakant.
- g. Shqyrtimi i propozimeve për amendamentet në statutin e FSHSH.
- h. Diskutime nga anëtarët për çështje të tjera.

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

Neni 18
Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme

1. KD mund të thërrasë një asamble të përgjithshme të jashtëzakonshme nëse mendohet se kjo është e domosdoshme.
2. Kur të paktën 1/3 e delegatëve të Asamblesë së FSHSH, bëjnë kërkesë me shkrim, KD është i detyruar të thërrasë një Asamble të Përgjithshme të jashtëzakonshme, jo më vonë se 2 muaj pas marrjes së kërkesës. Nëse asambleja nuk mbahet, anëtarët që e kërkuan atë, mund ta thërrasin mbledhjen vetë, duke ngarkuar një kryetar të përkohshëm me një grup pune.
3. Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së jashtëzakonshme duhet t'u dërgohet anëtarëve 30 ditë përpara ditës së zhvillimit të saj.
4. Rendi i ditës si dhe çdo dokument tjetër duhet t'u dërgohen anëtarëve 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
5. KD vendos për rendin e ditës kur Asamblenë e tërret ai. Kur ajo mbahet me kërkesën e 1/3 të delegatëve, rendi i ditës duhet të përmbajë pikat e ngritura nga këta anëtarë.
6. Rendi i ditës nuk mund të ndryshohet nga çfarëdo lloj kushtesh.

Neni 19
Vendimmarrja

1. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme kur janë prezent më shumë se gjysma e delegatëve (50%+1) që kanë mandat, me përjashtim të pikës 2 të këtij neni.
2. Nëse shumica e thjeshtë (50%+1) nuk arrihet, një Asamble tjetër e Përgjithshme duhet të bëhet 24 orë pas të parës, me të njëjtin rend dite. Nuk kërkohet shumicë për mbledhjen e dytë, përveç rasteve kur në rendin e ditës janë parashikuar amendamente në statutin e FSHSH, si zgjedhja e Presidentit dhe e KD-së, lirimi i një ose disa anëtarëve të një organi të FSHSH, përjashtimi i një anëtari të FSHSH ose shkrirja e FSHSH, për të cilën kërkohet një maxhorancë prej 2/3 e votave të dala nga votimi i te mandatuareve prezent.

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

3. Asambleja e Përgjithshme nuk duhet të marrë vendime për çështje që nuk janë parashikuar në rendin e ditës.
4. Anëtarët ushtrojnë të drejtën e votimit të tyre nepermjet perfaqesuesve të tyre me mandat. Një perfaqesues me mandat, nuk mund të përfaqësojë më shumë se një anëtar.
5. Vendimet duhet të merren me votim të hapur me përjashtim të rastit kur 1/3 e delegatëve kërkojnë votim të fshehtë. Në rast të votave të barabarta, vota e Presidentit është përcaktuese, kur votimi është i hapur.
6. Votimi me prokurë nuk lejohet.
7. Vendimet e marra nga Asambleja hyjnë në fuqi një ditë pasi ato janë miratuar, me përjashtim të rasteve kur Asambleja vendos për një datë të mëvonshme, ose ia delegon këtë të drejtë KD-së.

Neni 20

Drejtimi i Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme duhet të drejtohet nga Presidenti, ose në mungesë të tij nga z/v pretendëspresidenti. Kur edhe ai mungon mbledhja drejtohet nga anëtari më i vjetër i KD-së duke u emëruar Kryetar i ditës.
2. Asambleja cakton komisionin e numërimit të votave të përbërë nga 3-5 persona.
3. Drejtuesi i mbledhjes është përgjegjës për respektimin e rendit të ditës. Ai përcakton edhe kohën në dispozicion të çdo anëtari për diskutim.
4. Procedura e mbajtjes së procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm i cili i dërgon ato tek anëtarët brenda 20 ditëve mbas datës së mbledhjes.

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

Neni 21
Zgjedhjet

1. Zgjedhjet bëhen me votim të fshehtë.
2. Zgjedhjet (me përjashtim të Presidentit) duhet të bëhen mbi bazën e (50%+1) të votave të delegatëve prezent në raundin e parë, dhe pastaj në bazë të një numri më të madh të votave në raundin e dytë. Në rast se votat janë të njëjta bëhet një raund tjetër për të ndarë kandidatët, i cili përsëritet jo më shumë se tre herë. Në rast se përsëri ky votim është i njëjtë, kandidatët duhet të përcaktohen nga shorti, i cili organizohet nga komisioni i numërimit të votave.
3. Zgjedhja e Presidentit të FSHSH ka nevojë për 2/3 e votave të delegatëve prezent në mbledhje. Në rastet kur, asnjë nga kandidatët nuk arrijnë 2/3, atëhere dy kandidatët që kanë marrë numrin më të madh në raundin e parë kualifikohen për raundin tjetër. Në raundin tjetër, kandidati me numrin më të madh të votave zgjidhet. Në rast se numri i votave në raundin e dytë është i barabartë, atëhere zbatohen rregullat e përcaktuara në pikën 2.
4. Çdo kandidat duhet të propozohet nga të paktën një anëtar i FSHSH, jo më vonë se 20 ditë para datës së Asamblesë, në rendin e ditës të së cilës është vendosur zgjedhja e KD-së. Secili kandidat duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme.

Neni 22
Presidenti

Kandidati për President duhet:

- Të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri.
- Të ketë arsim të lartë.
- Të ketë figurë të pastër morale.
- Të ketë moshën mbi 30 vjeç.
- Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaja.
- Të mos ketë konflikt interesash me postin e presidentit.
- Të ketë kontribuar mundësisht në sportin e shahut si sportist, trainer, gjyqtar, gazetar apo donator (financues).

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

Neni 23
Detyrat e Presidentit

Detyrat e Presidentit janë si më poshtë:

- a. Të përfaqësojë FSHSH si i vetmi përfaqësues i saj.
- b. Të kërkojë thirrjen e AP dhe të thërrasë mbledhjet e KD-së.
- c. Të drejtojë Asamblenë e Përgjithshme po ashtu edhe takimet e KD-së.
- d. Të sigurojë zbatimin e vendimeve të AP dhe të KD-së.
- e. Në rast se Presidenti mungon, detyrat mund t'i ngarkohen zëvendës-presidentit.
- f. Ne rastin kur Presidenti jep dorëheqjen, KD cakton zëvendës-presidentin të kryejë funksionet e Presidentit përkohësisht, deri në thirrjen urgjente të Asamblesë së Jashtëzakonshme.

Neni 24
Komiteti Drejtues

1. Komiteti drejtues perbehet nga nje numer i caktuar personash (prej 5 deri 7 shtate vete), duke përfshirë ketu, Presidentin, z/v presidentin dhe anëtarët e tjerë.
2. Kandidati për anëtar i Komitetit Drejtues duhet:
 - a. Të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri.
 - b. Të ketë arsim të lartë.
 - c. Të ketë figurë të pastër morale.
 - d. Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaja.
 - e. Të mos jetë njëkohësisht trainer, gjyqtar, vëzhgues, sekretar klubi, apo anëtar i një organi gjykues të FSHSH.
 - f. Te mos jete njekohesisht anetar i nje federate tjeter (anetar komisioni, kolegjumi) etj.
 - g. Të mos jetë i dënuar nga një federatë sportive për thyerje disipline, përdorim dopingu apo për abuzime financiare.
 - h. Të jetë i propozuar nga një anëtar i federatës (klub sportiv apo shoqatë anëtare).
 - i. Të mos ketë konflikt interesash me të qënit anëtar i KD.

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

- j. Të ketë ushtruar sportin e shahut dhe të ketë fituar gjatë karrierës së tij si sportist apo trainer, të paktën një titull kampioni kombëtar, fitues i një kupe të nivelit kombëtar apo tituj nderkombetar, pse jo dhe tituj akademikë në shah.
3. Antaret qe propozojne kandidatin, nuk duhet te jene te pezulluar.
 4. Emrat e kandidatëve, bashkë me “kurikulumin” e tyre duhet të dërgohen nga anëtarët tek Sekretari i Përgjithshëm i FSHSH. Sekretari i Përgjithshëm verifikon kandidaturat dhe ia paraqet rezultatet KE-së për miratim. Lista e miratuar e kandidatëve, të cilët plotësojnë kushtet, i paraqitet delegatëve së bashku me rendin e ditës së Asamblesë. Për këtë veprimtari KE duhet të ngrejë një komision të posaçëm për seleksionimin e kandidaturave sipas kriterëve të përcaktuara në këtë statut.
 5. Një anëtar i FSHSH nuk mund të propozojë më shumë se një kandidat për anëtar në KD.

Neni 25 *Kohëzgjatja e Mandateve*

1. **Mandati i Presidentit, zëvendëspresidentit, sekretarit të përgjithshëm dhe anëtarëve të tjerë të komitetit ekzekutiv është 4 vjeçar. Ata kanë të drejtë të rikandidojnë, jo më shumë se dy mandate (rradhazi). Perjashtim ben vetem presidenti qe mund te rikandidoje me shume se dy mandate.**
2. KD plotëson vendin e mbetur vakant të anëtarit të saj në mbledhjen e Asamblesë së rradhës nëpërmjet votimit siç parashikohet në statut për zgjedhjet në FSHSH.

Neni 26 *Mbledhjet*

1. KD mblidhet të paktën gjashtë herë në vit.
2. Mbledhja drejtohet nga Presidenti.
3. Presidenti bën njoftimin për mbledhje 14 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes. 1/3 e anëtarëve të KD i kërkojnë Presidentit mbledhjen e KD jashtë rradhe. Presidenti duhet të mbajë mbledhjen brenda 3 (tri) javëve pas marrjes së kërkesës.

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

4. Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrë pjesë në mbledhjet e KD pa të drejtë vote.
5. Mbledhjet e KD nuk mbahen në publik. KD mund të ftojë palë të treta të marrin pjesë. Këto palë të treta nuk kanë të drejtë votimi dhe mund të shprehin opinionin e tyre vetëm me miratimin e Presidentit të FSHSH.
6. Për mbledhjet e KD mbahet procesverbal, i cili firmoset nga Presidenti, Sekretari i Përgjithshëm dhe nga çdo anëtar i KD pjesëmarrës në mbledhje dhe vendimet duhet të zbardhen brenda 5 (pesë) ditëve dhe të bëhen publike.
7. Procesverbali i mbledhjes ruhet në arkiv, në dy kopje. Për dëmtimin, falsifikimin apo humbjen e procesverbalit, përgjegjësit mbajnë përgjegjësi ligjore.

Neni 27

Kompetencat e Komitetit Drejtues

KD ka këto kompetenca:

- a. Të menaxhojë dhe drejtojë punët e FSHSH.
- b. Të planifikojë aktivitetet dhe kalendarin e veprimtarive.
- c. Të përcaktojë për secilin punonjës të FSHSH specifikat e punës.
- d. Të monitorojë administrimin e FSHSH.
- e. Të zgjedhë zëvendëspresidentin.
- f. Të pregatisë dhe të mbajë Asamblenë e Përgjithshme të Zakonshme dhe atë të jashtezakoneshme
- g. Të hartojë projektbuxhetin.
- h. Të emërojë dhe shkarkojë anëtarët e organeve gjykuese.

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

- j. Të emërojë dhe kur e sheh të arsyeshme, të shkarkojë anëtarët e komisioneve të përhereshme
 - k. Të përcaktojë, organizojë, dhe anullojë aktivitete zyrtare të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar.
- l. Te mbaje lidhje me organizata sportive Kombetare dhe ndërkombetare. Gjithashtu të ushtroje të drejtën për të propozuar përfaqësues të Federatës Shqiptare të shahut, për t'u zgjedhur në këto organizata.

Neni 28
Vendimmarrja

1. KD fillon mbledhjen vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
2. KD merr vendime me 50%+1 të anëtarëve të pranishëm. Në rastin e votave të barabarta, Presidenti ka votë vendimtare kur votimi është i hapur.
3. Në rast se një anëtar i KD ka konflikt interesash me çështjen për të cilën debatohet ai përjashtohet nga debati dhe votimi për këtë çështje.
4. Vendimet e marra rregjistrohen në procesverbal.
5. Vendimet e marra nga KD hyjnë në fuqi menjëherë, përveç rasteve kur KD vendos ndryshe.

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

KREU I IV

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Neni 29

1. Sekretari i Përgjithshëm është organi administrativ i FSHSH.
2. Ministri Përgjegjës për Sportin miraton njërën nga kandidaturat e paraqitura për Sekretar të Përgjithshëm të propozuara nga KD dhe të konfirmuar nga Presidenti.
3. Sekretari i Përgjithshëm mund të pezullohet nga KD për shkelje të rënda statutore apo abuzime të ndonjë natyre tjetër.
4. Kandidati për Sekretar i Përgjithshëm duhet:
 - a. Të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri.
 - b. Të ketë arsim të lartë, mundesisht: ***Akademe e Larte te Sporteve***, jurist, ekonomist, apo dege te tjera te pranueshme nga kualifikimet shahistike.
 - c. Te kete figure te paster morale
 - d. Të ketë moshën mbi 30 vjeç.
 - e. Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj.
 - f. Të mos jetë njëkohësisht trajner, gjyqtar, vëzhgues, sekretar klubi apo anëtar i një organi gjykues të FSHSH.
 - g. Të mos jetë njëkohësisht anëtar i një federatë tjetër (anëtar komisioni, kolegji etj).
 - h. Të mos jetë i dënuar nga një federatë sportive për thyerje disipline, përdorim dopingu apo për abuzime financiare.
 - i. Të mos ketë konflikt interesash me të qenit Sekretar i Përgjithshëm.

Miratohet
Ministri
Ylli Pango

5. Funkcionet e tij janë:

- a. Të zbatojë vendimet e KD.
 - b. Të bëjë përgatitjet për Asamblenë e Përgjithshme dhe për mbledhjet e organeve të tjera dhe komisioneve.
 - c. Të njoftojë rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme dhe të takimeve të KD
 - d. Të mbajë korespondencën e FSHSH.
 - e. Të mbajë librat e llogarisë së FSHSH.
- 6.** Ai është përgjegjës për mbarëvajtjen, funksionimin dhe menaxhimin e stafit që punon brenda tij.
- 7.** Ai merr pjesë rregullisht në Asamblenë e Përgjithshme, takimet e KD dhe në ato të komisioneve në rol keshillues. Raporton për zbatimin e vendimeve të marra dhe aktivitetet e kryera. Nëse ai nuk është në gjendje të marrë pjesë, duhet të caktojë një zëdhënës.
- 8.** Të informojë strukturat përkatëse shtetërore për mirëmenaxhimin e grantit, financimeve apo lehtësimeve fiskale që bën shteti për federatën.

Neni 30

Përfashtimi i një Personi të Zgjedhur

1. KD mund të pezullojë një anëtar të KD për shkelje statutore, abuzime financiare të faktuara nga organi kompetent apo për ndonjë shkelje apo veprim tjetër që KD e çmon si ngjarje të rëndësishme.
2. Asambleja e Përgjithshme ka autoritetin që ta përjashtojë një anëtar kur propozimi për përjashtim votohet me 2/3 e anëtarëve të plotë që përbëjnë Asamblenë e Përgjithshme të federatës.
3. Kur 1/3 e anëtarëve që përbën Asamblenë e Përgjithshme kërkon përjashtimin e presidentit për një arsye të paraqitur në mocionin e mosbësimit, Asambleja e Përgjithshme ka autoritetin për të marrë vendimin ose jo të përjashtimit, kur ky propozim votohet me 2/3 e anëtarëve të numrit të përgjithshëm që përbëjnë asamblenë.
4. Mocioni i paraqitur nga 1/3 e anëtarëve për çfarëdo problemi është detyrues për KD-në e federatën, për të mbledhur asamblenë e përgjithshme.

Miratohet
Ministri
YlliPango

KREU V
FINANCAT
Neni 31
Periudha Financiare

1.Periudha financiare do te jete viti kalendarik

Neni32
Burimet Financiare

Të ardhurat e FSHSH sigurohen nga:

- a. Granti i përcaktuar nga Ministria përgjegjëse për sportin.
- b. Rregjistrimet vjetore të anëtarëve.
- c. Të ardhurat e krijuara nga marketingu i të drejtave që gëzon FSHSH.
- d. Nga sponsorizimet, donacionet, financimet nga shteti dhe burime të tjera të lejuara.
- e. Nga licensimi i trainerëve, sportistëve, gjyqtarëve, mjekëve, vëzhguesve, specialistëve, amatorëve.
- f. Nga kuotat e anëtarësimit në FSHSH.
- g. Të ardhurat nga FIDE dhe ECU.

Neni 33
Ndalimi i perdorimit te simulanteve

- 1.FSHSH ndalon që anëtarët e saj në aktivitetet sportive të FSHSH, kombëtare apo ndërkombëtare të përdorin substanca të ndaluara stimuluese. Në rast përdorimi të këtyre substancave qëndrimi i FSHSH ndaj anëtarëve të saj është në përputhje me rregulloret e FIDE dhe ECU.
- 2.Në të njëjtën kohë FSHSH njih dhe pranon edhe autoritetin e Komisionit Kombëtar të Antidopingut.

Miratohet
Ministri
YlliPango

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 34

1. Për çështjet që nuk parashikohen në këtë statut ose për çështje të forcave madhore do të zgjidhen duke ju referuar dispozitave të ligjit nr.9376, datë 21.04.2005 “Për Sportin”, Kodit civil, ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat Jofitimprurëse”, ligjit 8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, ligjit nr., datë “për sponsorizimet”, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.
2. Çdo ndryshim i statutit të FSHSH, përpara se të regjistrohet në Gjykatën kompetente miratohet me Urdhër të Ministrit përgjegjës për Sportin.
3. Në rast mosmarrëveshjes brenda FSHSH, të cilat çojnë në paralizimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së FSHSH, Ministri përgjegjës për Sportin ka të drejtë të pezullojë veprimtarinë e organeve drejtuese të FSHSH dhe të emërojë me mandat të përkohshëm një Kryetar të FSHSH për të drejtuar veprimtarinë e federatës dhe për të përgatitur thirrjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme Zgjedhore.

Neni 35

Ky statut u hartua në katër kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi, pasi miratohet në parim dhe nën për nen, në Asamblenë e datës 09 Shkurt 2008, të firmoset nga Ministri i Sporteve dhe të legalizohet në gjykatë.

PRESIDENTI

SEKRETARI I PERGJITHSHEM

VASIL GJIKA

SABRI BEJLERI